



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryetar i Këshillit Drejtues
Muharrem Nitaj

Nr. Prot.: 3/570
Datë: 23/12/2013

Në bazë të nenit 13, pika 1.14 të Statutit të UP-së, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.12.2013, miratoi:

RREGULLOREN
Institutit për Hulumtime Biologjike dhe Mjedisore
(IBEM)

Neni 1
Dispozitat e përgjithshme

1.1. Institutit për Hulumtime Biologjike dhe Mjedisore është institut i themeluar në kuadër të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN), nga Universiteti i Prishtinës, në bazë të Rregullores 2/513 (dt. 25.10. 2013) të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës.

Neni 2.
Qëllimi dhe veprimtaria

2.1. Qëllimi i Institutit për Hulumtime Biologjike dhe Mjedisore është:

- Të avancojë hulumtimet në fushën e biologjisë, ekologjisë, biokimisë, fiziologjisë, biodiversitetit, biomonitorimit, ekotoksikologjise, gjenotoksicitetit, fiokimisë, etnobiologjisë, etj.
- Të avancojë infrastrukturën për punë kërkimore-shkencore me qëllim të ofrimit të shërbimeve në fushat e Biologjisë dhe Mjedisit për aktivitete të ndryshme socio-ekonomike.
- Të avancojë njohuritë mbi resurset biologjike në Kosovës, në mënyrë që të sigurojë bazë për konservimin, menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm.
- Të vlerësojë ndikimin e aktiviteteve njerëzore dhe ndotësve të ndryshëm në mjedis, biodiversitet dhe shëndet.

- Të nxise aktivitetet hulumtuese te Departamentit te Biologjise, FSHMN dhe UP dhe të rrisë bashkëpunimin për punë hulumtues-shkencore me individë dhe institucione brenda dhe jashtë Kosovës.
- Të promovojë bashkëpunimin me sektorin publik dhe privat për zgjidhjen e problemeve mjedisore.
- Të krijojë infrastrukturën e nevojshme, për hulumtime biologjike-mjedisore ne Departamentin e Biologjise, FSHMN dhe UP..
- Të zhvillojë kapacitetet njerëzore në Departamentin e Biologjise, UP dhe më gjerë për veprimtari shkencore-kërkimore në fushën e Biologjisë dhe Mjedisit
- Të promovojë edukimin, trajnimin dhe zhvillimin e shkathtësive në praktikat menaxhuese ekologjike dhe mjedisore.

2.2. Për të realizuar qëllimet nga neni 1, Instituti merret me veprimtaritë e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në këto:

- Do të realizojë hulumtime që lidhen me ruajtjen e natyrës, shëndeti dhe mjedisit (metoda të biomonitoringut, vlerësimit të ndikimit te ndotjes se mjedisit ne sisteme te gjalla, vlerësimin e statusin ekologjik të llojeve, ekosistemeve dhe zonave të ndryshme ekologjike, kontribuojnë në hartimin e politikave mjedisore, zbatojnë njohuritë e përgjithshme teorike nga disipinat e biologjisë, mjedisit dhe shkencave tjera fizike në menaxhimin e drejtë të resurseve natyrore).
- Do të realizojë dhe mbështes hulumtimet shkencore për vlerësimin e ndikimit te aktiviteve të ndryshme antropogjene në sisteme biologjike, mjedis dhe hapësirën rrethuese.
- Do të realizojë dhe promovojë studime interdisiplinare të cilat kanë për qëllim ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit, resurseve biologjike dhe shëndetit.
- Do të ofrojë analiza dhe realizojë hulumtime në fushat e biologjisë dhe mjedisit.
- Do të rekomandoj aktivitetet për zhvillim socioekonomik të qëndrueshëm dhe promovoj mbrojtjen e mjedisit, si dhe të bëjë edukimin dhe trajnimin e shkencëtarëve të rijë në fushën e ekologjisë dhe mjedisit.
- Do të realizojë hulumtime për inventarizimin, menaxhimin, shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe konservimin e biodioversitetit.
- Do të ndërtojë bashkëpunim shkencor-profesional me institutet, institucionet, dhe organizatat apo individët brenda dhe jashtë vendit, përmes participimit në projekte që

lidhem me hulumtime ekologjike edhe mjedisore (Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit, Institutin për Mbrojtjen e Natyrës, Institutin Kombëtarë të Shëndetit Publik, etj.).

- Do të ofrojë shërbime për sektorin publik dhe privat.
- Do të organizojë dhe mbështes seminarët, konferencat, punëtoritë, trajnimet, forumet dhe format e tjera të organizimeve publike.
- Do të ndihmojë publikimin dhe blerjen e revistave, librave, e materialeve të tjera shkencore e profesionale.
- Do të përgatise programe dhe materiale edukative për ngritjen e ndërgjegjes publike për mjedisin.

Neni 3. Organet

3.1. Organet e Institutit janë:

- 3.1.1. Këshilli i Institutit
- 3.1.2. Drejtori i Institutit
- 3.1.3. Sekretari i Institutit

Neni 4. Këshilli i institutit

4.1. Këshilli i Institutit përbëhet nga pesë anëtarë:

- 4.1.1. Prorektori për kërkime shkencore ose ndonjë përfaqësues tjetër i caktuar nga Rektori i UP-së;
- 4.1.2. Prodekani FSHMN-së për çështje mësimore ose ndonjë përfaqësues tjetër i caktuar nga Dekani i FSHMN-së;
- 4.1.3. Shefi i Departamentit të Biologjisë;
- 4.1.4. Një anëtar nga stafit akademik i Departamentit të Biologjisë,
- 4.1.5. Një anëtar i jashtëm, nga komuniteti akademik, i biznesit apo ndërmarrësish, nga Kosova apo jashtë saj, i propozuar nga Shefi i Departamentit të Biologjisë dhe i miratuar nga dekani FSHMN-së.
- 4.1.6. Anëtarët e këshillit do të kenë mandat 4 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.
- 4.1.7. Këshilli e zgjedh kryesuesin nga radhët e veta.
- 4.1.8. Kryesuesi i thërret dhe i udhëheqë mbledhjet e këshillit.
- 4.1.9. Vendimet e këshillit merren me shumicë votash.
- 4.1.10 Drejtori i Institutit është anëtar i Këshillit të Institutit, por pa të drejtë vote.

Neni 5.

- 5.1. Institutin e udhëheq Drejtori i tij, i cili është përgjegjës për të gjithë aktivitetin e tij hulumtues-shkencor dhe publikues.
- 5.2. Drejtori i Institutit zgjidhet nga këshilli i institutit me mandat 4- vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.
- 5.3. Drejtori duhet të jete nga radhët e stafit akademik (profesorëve) të Departamentit të Biologjisë.
- 5.4. Në punën e tij, Drejtori përkrahet nga Sekretari i Institutit, i cili propozohet nga Drejtori dhe aprovohet nga Këshilli i Institutit.
- 5.5. Sekretari duhet të jetë nga radhët e stafit akademik të Departamentit të Biologjisë.
- 5.6. Drejtori dhe sekretari duhet të përkujdesen për informimin, aranzhimin e takimeve, konferencave dhe të kryejnë punët tjera të nevojshme, me përkushtim që sa më shumë të angazhojnë stafin e Departamentit të Biologjisë.

Neni 6.

Financimi

- 6.1. Aktivitetet e Institutit mund të financohen nga burimet vijuese:
 - 6.1.1. Nga fonde publike, përfshirë UP-në;
 - 6.1.2. Nga projektet;
 - 6.1.3. Nga aktiviteti vetanak;
 - 6.1.4. Nga donacionet;
 - 6.1.5. Nga burime të tjera, në përputhje me ligjin dhe Statutin.

Neni 7.

Raportimi dhe llogaridhënia

- 7.1. Në fillim të çdo viti kalendarik, drejtori i Institutit e prezanton raportin vjetor për vitin e mbaruar akademik dhe planin vjetor për vitin akademik vijues në lidhje me aktivitetet e Institutit.
- 7.2. Këshilli voton për ta aprovuar Raportin vjetor dhe ndaras voton edhe për programin vjetor.
- 7.3. Kryesuesi i këshillit ia dorëzon raportin vjetor dhe planin vjetor të miratuar dekanit të FSHMN-së dhe Prorektorit për kërkime shkencore të UP-së.
- 7.4. Dekani i FSHMN-së i procedon për miratim në Rektorat (te prorektori për shkencë) dhe në Këshillin Drejtues.

Neni 8.
Kontraktimi i punëve

- 8.1. Pas arritjes së marrëveshjes për kontraktimin e punëve, rektori, në bazë të të dhënave për marrëveshjen e arritur për kontraktimin e punëve, nënshkruan kontratën, e cila duhet të përmbajë:
- 8.1.1. Të gjitha elementet e marrëveshjes së arritur
 - 8.1.2. Përcaktimin preciz të punëve dhe detyrave të punës
 - 8.1.3. Vlerën precize të kontraktuar për secilin pozicion dhe punë
 - 8.1.4. Vlerën e tërësishme të punës
 - 8.1.5. Afati e kryerjes së punë
 - 8.1.6. Mënyrën e pagesës dhe afatin e ekzekutimit të pagesës
- 8.2. Para se të lidhet kontrata nga Neni paraprak, Drejtori i Institutit, me pëlqimin e Dekanit të FSHMN-së, e cakton bartësin e punës dhe kryesit e tjerë të punëve, duke marrë si kriter themelor mendimin e kontraktuesit të punëve, kompetencat profesionale e shkencore të kryesve të punës, si dhe mendimin e porositesit të punëve.
- 8.3. Në projektet dhe aktivitetet e veta, Instituti mund të angazhojë edhe ekspertë jashtë UP-së.

Neni 9.


Ndarja e mjeteve të realizuara dhe pagesat për punën e kryer.

- 9.1. Pagesa e punëve të kryera bëhet sipas rregulloreve përkatëse të UP.
- 9.2. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara në bazë të punëve në specifikim do të bëhet në bazë të rregulloreve të Këshillit Drejtues të UP.
- 9.3. Ndarja e mjeteve financiare të realizuara nga projektet apo shërbimet në bazë të punimeve të kryera bëhet sipas rregulloreve përkatëse.
- 9.4. Dekani i FSHMN-së e përpilon raportin mbi ndarjen e mjeteve dhe ia dërgon shërbimit financiar, i cili e përpilon aktvendimin lidhur me pagesën e punëkryesve, dhe e jep urdhëresën për pagesën e mjeteve të destinuara sipas raportit të Dekanit.

Neni 10.

Për çfarëdo interpretimi apo kontesti, vlejné ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së



Muharrem Nitaj